

## NË EMR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**-Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbeër prej gjyqtarit Xheladin Osmani, si kryetar dhe gjyqtarve Fatmir Krasniqi dhe Nazim Vllaço, si anëtar të trupit gjykues, në lenden penale kunder të akuzuarit K.K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vrasje në tentative nga nei 178 lidhur me nenin 28 të KP, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP, dhe B.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KP, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren,- Departamenti i krimeve të rënda PP.nr.8/15, e dt.17.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimeve kryesore publik, më datë:16.09.2015,15.10.2015., 19.12.2015, 10.02.2016, 25.02.2016, 02.03.2016, në prezencën e prokurorit të shtetit Mehdi Sefa, mbrojtësve, av. N.Q.dhe R.K. , si të akuzuarëve më dt. 09.03.2016 muar dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

**1.K.K.**, nga i ati M. dhe e ëma B. , i lindur me datën “data e lindjes..” në fshatin ..... Komuna e Rahovecit, tani me vendbanim në Prizren, në lagjen “ .... . ..” në rr.” ..... ”, shqiptar, shtetas i R.Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, pa fëmijë i gjendjes së dobët ekonomike.

**2.B.B.** i, nga ia ti I. dhe e ëma H. , me mbiemër të vajzërisë B. , i lindur me date “data e lindjes..” , në fshatin ..... , Komuna e Prizrenit, tani me vendbanim në Prizren, në lagjen “ ..... ”, në rr.” .... ”, shqiptar, shtetas i R.Kosovës , ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike.

### JANË FAJTORË

#### Se i akuzuari K. K.

**I.**Me date 19.01.2015, rreth ores 18:00 minuta, në rr.” .... ” në lagjen “ ..... ” në Prizren, pas një mosmarëveshjeje paraprake në vendin e punës, me dashje tenton të privon nga jeta të dëmtuarin B. B. , në atë mënyrë që i akuzuari K.K. shkon në shtëpin e B.B. me bicikletën e tij, fillimisht perms bashkëshortes që ishte duke larë enet në oborr, i thot asaj që ta fton bashkoshortin-B.B. , me pas B.B. del jashtë, e shef se aty ishte i akuzuari K.K. , hynë mbrenda në shtëpin e tij, merr pushken gjysem automatike (10-she) me nr. serik II2308230 dhe i akuzuari K.K. fillon të shtëpë pa ndërprerë me pushkën automatike AK-47 me numër serik 12108355 në drejtim të shtëpisë, edhe i akuzuari B.B. i përgjigjet duke shten me armë, me ç’ rast nga të shtena e të akuzuari K.K. , të akuzurit B.B. i shkakton lëndime të lehta me armë zjarri në parakrahun dhe shputën e këmbës së majtë të cilët dëmtime janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit, më përsëafërmi e përshkruar në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr.M. G. të datës 13.02.2015.

Me këtë ka kryer veprën penale vrasje në tentative nga nei 178 lidhur me nenin 28 të KP,

II.Me date, kohë dhe vendin e njejtë sin ë dispozitivin e pare të këtij aktvendimi për fillimin e hetimeve, i akuzuari mbanë në pronësi armën e zjarrit të markës AK-47 me numër serik 12108355 në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla, me ç' rast arma i konfiskohet nga policia.

### **I akuzuari B. B. .**

I.Me date, kohë dhe vend të njejtë, si në dispozitivin të këtij aktvendimi, pa një mosmarëveshtje paraprake, në shtëpin e tij e përdorë në kundërshtim me Ligjine zbatueshëm armën gjysëmatomike (10-she), me numër serik II2308230.

Me këtë ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KP.

2.Me date, kohë dhe vendin e njejtë sin ë dispozitivin e pare të aktvendimit për fillimin e hetimeve, i pandehuri mbanë në pronësi pushkën gjysëmatomike 10 (she) me numër serik II230820 dhe 36 fishekë të kal.7.62 mm, në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, me ç' rast e njejtë i konfiskohet nga policia.

Me këtë ka kryer veprën penale mbajtja, në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP.

Gjykata në bazë të nenit 3,7,8,9,10,21,,41,42,43,45,46,47,73,74,75,76 të KP ,

## **V e r t e t o n**

**Të akuzuarit K. K. ,** për veprën penale vrasje në tentativ nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj

Për veprën opemnale mbajtja në pronësi, kontrollë ose në posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP, dënimin me burg në kohëzgjatje prej5 (pesë) muaj.

Gjykata në kuptim të nenit 80 të KP,

## **G J Y K O N**

**Të akuzuarin K. K. me denim UNIK, me burg në kohgjatje prej 2 (dy) viteve** ku do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës dt19.01.2015 gjërë më daten 09.03.2016, në denimin e shqiptuar.

**Të akuzuarit B. B. ,** për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshem nga neni 375 par.1 të KP, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve, nëse i akuzuari nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër të re penale.

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose në posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP, dënimin me gjobë në shumen prej 700,00 (shtatqindë), dhe këtë shumë duhet ta opaguaj në tri kiste mujor duke filluar për fillim të muajve vijues, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. .

Nese i akuzuari B. B. dënimin e shqiptuar me gjobë në shumen prej 700,00 (shtatqindë) euro, nuk mundet apo nuk deshiron ta paguaj, gjykata për qdo 20 euro dotë ia caktoj një ditë burgim.

I akuzuari-si i dëmtuar B. B. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

Obligohen të akuzuarit K. K. dhe B. B. që secili të paguaj edhe paushallin gjyqësor me nga 300 (treqindë) euro, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e formës së prerë të aktgjykimit.

Gjykata, në bazë të nenit 374 par.3 e lidhur me nenin 69 të KP, ndaj të akuzuarve shqipton dënim plotësues;

### **MARRJEN E SENDIT**

Ashtu që prej të akuzuarit K.K. , mirret arma -pushkën automatike AK-47 me numër serik 12108355 , ndersa nga i akuzuari B. B. , pushka gjysem automatike (10-she), me nr. serik II2308230, 36 fishek të kal.7.62 mm..

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzen PP.nr.08/2015, të dt.17.03.2015, K. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vrasje në tentative nga nei 178 lidhur me nenin 28 të KP, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP, dhe B. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP, aktakuzë të ciln në të gjitha fazat e shqyrtimeve e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa, i cili fjalën perfundimitare e deponuar me shkrim ku ka theksuar:

Prokuroria e shtetit mbetet në tërsi pranë aktakuzes PP.nr.08/2015 të dt.17.03.2015, ndaj të akuzuarve K. K. , për veprën penale vrsje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP, si dhe ndaj të akuzuarit B. B. , për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 (e rikualifikuar gojarisht në shqyrtimin kryesor të dt.09.03.2016) nga par.2 në par.1 të këtij neni), , meqë në provat e administruara ndëgjimin e deshmitares B. B.1 , , deshmitarve Dr. S. H. , por edhe të ekspertit mjeko-ligjor Dr. M. G. , ndëgjimit të ekspertit të bailstikes L. R. , së bashku me rapoertin e ekspertizës të dt.06.07.2015dhe fotodokumentacioni.

Pamëdyshje nga këto prova është vertetuar përshkrimi faktik dhe elemntet esenciale të veprave penale të përshkruara sin ë dispozitivin e aktakuzës prej I deri në IV , K.K. me dt.19.01.2015, në rrugen “ ... ..... ”, Lagjen ..... në Prizren, pas një mosmarrveshje paraprake në vendin e tyre të punës, me dashje tenton ta privon nga jeta të demtuarin B. B. , në atë mënyrë që I akuzuari K.K. me bicikletë shkon në shtepin e B. B. ,

fillimisht e fton të demtuarin që të del jashtë pas thirrjes del bashkëshortja, më pas B.B. del jashtë dhe i akuzuari pa kurrfar paralajmërimi fillon të shtënë pa ndërprerë me pushkën automatike AK-47 me numër serik 12108355 në drejtim të shtëpisë me ç' rast I shkakton lëndime të lehta me armë zjarri të dëmtuarit B. B. në parakrahun dhe shputën e këmbës së majtë të cilat dëmtime janë shkaktuar nga veprimi dinamik I predhës së armës së zjarrit, më për së afërmi e përshkruar nëmëndimin e mjekut ligjor Dr.M. G. të datës 13.02.2015. Poashtu është vërtetuar se në veprimet e K.K. dhe B. B. formohen elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1, duke shtuar se në veprimet e të akuzuarit të dytë përveç kësaj vepre formohet edhe vepra penale përdorimi I armës apo mjetit të rrezikshëm nga nei 375 par.1 të KP. Që të dy të pandehurit për posedim të armëve pa leje kanë pranuar fajsinë.

Nga këto që u theksuan më lartë, duke marrë për bazë aktakuza e prokurorisë e shtetit është provuar në tërësi kërkojmë nga trupi gjykues që të akuzuarit K. K. për veprën penale të përshkruar si nën I/ dhe II/ të dispozitivit të aktakuzës, si dhe B. B. për veprat penale sin ë dispozitiv nën III/ dhe IV/ ti shpallë fajtor dhe ti dënojë sipas Ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata të ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

### **Kompetencat**

Ligji mbi Gjykatat, ligji nr.03/L-99 (LC) gjithashtu ka hyrë plotësisht në fuqi me 1 Janar 2013 (neni 430) më të cilin e rregullon kompetencën teritoriale dhe lëndore të gjykatës.

Vepra penale bie në kompetencën teritoriale dhe lëndore të Gjykatës Themelore në Prizren, vrasjet dhe vrasjet e rënda kanë dënimin prej se paku 5 vite respektivisht 10 vite burgim dhe bien në kompetencë lëndore të Gjykatës Themelore –Departamenti për Krime të Rënda (neni 20 par1) të KPP dhe nenit 11 të Ligjit për Gjykatat , Ligji nr.03/L-199, pasi që vepra penale është kryer në territorin e Komunës së Prizrenit, e kjo bie në kompetencën e Gjykatës Themelore në Prizren, (neni 29 0 të KPP)

I vetmi dallim është rikualifikimi i veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP, në nenin 375 par.1, në bazë të rikualifikimit të veprës penale që bëri prokurori i shtetit në fjalën e tij të fundit.

### **Mbajtja në pronësi, kontrolle ose në posedim të paautorizuar të armeve.**

Kjo qeshtje rregullohet ne nenin 374 par.1 të KP. “kushdo që mban në ronësi, kontrolle ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla , dënohet...”

Trupi gjykues konsideron se kontrolli përfshin ruajtjen apo mundësin e qasjes së armës dhe posedimi përfshin posedimin personal të armës njësoj sikur ta kesh armen.

Arma apo pushka automatike “AK-47” me numër serik 12108355 të cilën e ka përdorur i akuzuari K. K. dhe arma apo pushka gjysëmautomatike (10-she) me numër serik II230820 e kal.7.62 mm, dhe 36 fishekë të të njëjtit kalibër, përkufizohet nga neni 120 par.38.1 si armë

zjarri, gjithashtu ky nen e përkufizon municionin për armë zjarri si armë dhe sipas Ligjit për armët për të cilat nuk mundë të mirret leja nga personi fizik.

I akuzuari K. K. , në shqyrtimin fillestar pastaj edhe shqyrtimin kryesor ka pranuar fajsinë për veprat penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pa autorizuar të armëve nga nei 374 par.1 të KP,

Në bazë të pranimit të fajsisës nga ana e të akuzuarit K. K. vertetue në tersi se i njëjti me date, kohë Me date, kohë dhe vendin e njëjtë sin ë dispozitivin e pare të këtij aktvendimi për fillimin e hetimeve, i akuzuari mbanë në pronësi armën e zjarrit të markës AK-47 me numër serik 12108355 në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla, me ç' rast arma i konfiskohet nga policia.

Gjithashtu i akuzuar i B. B. , në shqyrtimin fillestar pastaj edhe shqyrtimin kryesor ka pranuar fajsinë për veprat penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pa autorizuar të armëve nga nei 374 par.1 të KP,

Në bazë të pranimit të fajsisës nga ana e të akuzuarit B. B. është vertetue në tersi se i njëjti Me date, kohë dhe vendin e njëjtë sin ë dispozitivin e pare të aktvendimit për fillimin e hetimeve, i pandehuri mbanë në pronësi pushkën gjysëmautomatike 10 (she) me numër serik II230820 dhe 36 fishekë të kal.7.62 mm, në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, me ç' rast e njëjta i konfiskohet nga policia.

Trupi gjykues vërtetoi se të akuzuari kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, nga materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çart ligjore ose gabime faktike, të akuzuarit K. K. dhe B. B. e pranuan fajësinë për veprat penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e PTH-it në Prizren, e po ashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprën penale që u vihet në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve, formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP, dhe se të akuzuarit K. K. dhe B. B., janë përgjegjës në aspektin penal- juridik, për çka gjykata të njëjtët i shpalli fajtor, dhe ua shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

**Meqenëse i akuzuari K. K.** nuk pranoj vepren penale vrasje në tentative nga nei 178 lidhur me nenin 28 të KP, si dhe i akuzuarit B. B. nuk pranoj fajsin për vepren penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KP, gjykata pastaj administroi me provat e propozuara, më dt.16.09.2015 ka dëgjuar dëshmitarën B. B.1 , për dt. 15.10.2015 ka ftuar dhe ka degjuar ekspertin mjeko-ligjor, DR. M.G. , për dt. 19.11.2015, ka ftuar dhe ka degjuar dëshmitarin Dr. S. H. , më dt.11.02.2016, ka degjuar ekspertin e forenzikes, L. R., është bërë shiqimi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. M.G. të dt.13.02.2015, në raportim mjekësor të

Qendrës Emergjente në Prizren, me nr.1454 të dt.19.01.2015, në listen e armeve të konfiskuara të dt.19.01.2015, me nr. të rastit 2015-GA-0165, në Fotoalbumin e Njësitit të Forenzikës të dt.19.01.2015, në listen e deshmive të Njësitit të Forenzikës të dt.19.01.2015 me numer të rastit 2015-GA-0165, në skicen e vendit të ngjarjes , në tabelen e matjeve në vendin e ngjarjes të Njësitit të Forenzikës.

**Deshmitarja B. B.1 , deklaroj se** deklarojë se para datës 19.janar 2015 e kam njohur K. K. dhe para kësaj date ka qenë edhe në shtëpin tonë dhe ate një herë me na rregullu një derë. E di që se K.K. dhe B.B. kanë punue në një ndërmarrje dhe B.B. , bashkëshorti më ka treguar se 2-3 ditë para se të ndodhë rasti marëdhënjet e tyre janë acaruar, më ka thënë se ka pas disa fjalosje me K.K., unë i kam thënë “hajt bre K.K. kaloje atë punë”. Me 19.janar 2015 kur bashkëshorti im ka ardhur në shtëpi, ditën kritike prej orës 16:30 gjerë në ora 17:00 kemi hangër darkë dhe B.B. më ka shprehur do brenga pakënaqësie që ka patur me kolegun e tij të punës, këtu të akuzuarin K.K. . Në shtëpi kemi qenë unë dhe bashkëshorti dhe dy vajzat dhe djali 12 vjeçar. K. K. në shtëpin tonë ka ardhur pas orës 18:00 veç ka qenë terr atë natë, unë në një moment dola jashtë për punët e mija në oborr dhe aty kam ndëgju disa thirrje duke mu drejtuar K.K. , “thirre B.B.”, unë kam ndëgju vetëm zërin kur ka thënë “thirre B.B.”, pastaj menjëherë kam shku në shtëpi dhe i kam thënë bashkëshortit se po të thirre një person, nga se unë nuk e kam pa se ka qenë këtu K. K. . E kam pa vetëm me bicikletë por nuk më ka shku mendja me pa se çka ka pas me veti në dorë. Kur kam shkuar ta thërras bashkëshortin ai ka qenë në banjo, unë nuk kam shkuar në banjo por jemi takuar në korridor me bashkëshortin kur në atë moment del B.B. dhe aty në korridor se po të thirre dikush, më tha “mi sill trenerkat dhe qorapat” dhe tuj ia pru që kërkojë bashkëshorti u ndëgjua arma kur është repetu dhe bashkëshorti më tha se ky paska ardhë me një qëllim të keq. Bashkëshorti nga shtëpia nuk ka dal, por ka dal në ballkon të shtëpisë duke theksuar se unë kam dalë e para para bashkëshortit tim, në oborr ndoshta 5 m, prej K.K. dhe e kam pyet ate “çka po të duhet B.B.” më tha “thirre B.B. dhe pse i shymët dritat”, pastaj B.B. – bashkëshorti e ka marrë armën e vet, unë kam dalë para K.K. dikund 7-8 m, duke më thënë “thirre (me zë të lartë B.B.) dhe ka krisë arma.

Me armë është gjujtë në drejtimin tonë dhe K.K. ka shti me armë, kur është gjuajtur me armë K.K. ka qenë në korridor të shtëpisë. B.B. – bashkëshorti e ka patur me veti armën, siç deklarova edhe ma herët ka shku dhe e ka marrë armën, ka dalë me armë në ballkon, ndoshta edhe 2 m, në oborr meqë ballkoni është shumë i ulët nga oborri. Unë e di që bashkëshorti ka poseduar armë, e cila i ka mbetur qysh nga lufta. Kur ka gjuajtur K.K. në drejtim të shtëpisë e pastaj edhe në B.B. , vajzat kanë qenë shumë afër meje dhe ka qenë shumë shqetësuese, e stresuar, nuk e di se sa herë është gjuajtur me armë. B.B. është lënduar në dorë dhe në këmbë dhe ka patur edhe pika gjaku aty afër. Zgjatja me armë ka qenë gjerësa janë hargjuar fyshekët .

Në pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit se shtëpia ku banon a është shtëpia e re, deklarojë se po, me fasad, saq i përket dritareve se a kanë qenë në atë kohë të mbyllura apo të hapura, ka qenë dimër, ftoftë, nuk më kujtohet, mundet me u lanë dritarja kiper por mund të shiqohet edhe nga perdja.

Në kohën kur e kam dhënë deklaratën në polici kam qenë shumë e stresuar, kanë kaluar disa muajë dhe sot kam harruar se kkush dhe çka më ka thënë, Kur kanë filluar të shtënat unë kam qenë në oborr, gjerësa isha brenda nuk ka patur të shtëna. Kam parë që K.K. ka qenë nja 6-7 m, jashtë oborrit në vendin ku ka krisë me armë, oborri ka qenë i rrethuar me Itela të dukshëm nga brenda në jashtë, ndërsa pjesa ku ka qenë K.K., është rrugë me kubëza të betonit, nuk më kujtohet se a ka ndriqim rruga, por e di që para neve është një fabrikë, e cila jep ndriqim edhe lagjes.

Unë e kam pa K.K. duke gjuajtur me armë, por edhe kam pa edhe kur B.B. ka gjujtë, por nuk e di në drejtim të kujt ka gjujtë. Gjatë gjuajtjes me armë bashkëshorti im ka qenë në oborr dhe K.K. kur ka gjujtë me armë nuk e di a ka gjuajtur në drejtim të shtëpisë apo të B.B. nuk e di qëllimin e K.K., por e di që plumbat kanë ardhur në drejtimin tonë, ku janë goditur edhe muret e shtëpisë dhe akoma ka shenja.

Në pyetjet e mbrojtësit avokatit R. K. se a të kujtohet dhe a ke mujtë me identifiku se kush po e thirre bashkëshorten në bazë të zërit, dëshmitarja deklaroi jo nuk kam mujtë, për këtë arsye e kam thirre B.B. . Vendi kur ka gjuajtur K.K. me armë ka pamje të mirë, nga ballkoni dhe oborri shifet mirë vendi se ku ka qenë K.K. . Gjujtjet kanë qenë rafalë.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.K., avokati N.Q. , propozoj që në plotësimine procedurës së provave të dëgjohet eksperti i balistikës – kriminalistikës për arsye se nga provat materiale të cilat i ka na dispozicion gjykata dhe palët ekziston edhe skica nga vendi i ngjarjes e punuar nga Njësia e Forenzikës të policisë së Kosovës dhe provat të cilat janë siguruar në vend të ngjarjes. Në dispozitiv të aktakuzës në mënyrë të qartë është theksu dëmtimet janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrtë, në deklaratën e të akuzuarit B. B. dhënë në procedurën paraprake në procesverbalin e datës 30.02.2015 në faqen 3 në pasusin 4 në rreshtin 8 i njëjti ka deklaruar: “por sikundër tash edhe nga të shtënat në drejtim të shkallëve një copë e betonit është plasaritë dhe më ka lëndu këmbën e majtë”, për këtë pjesë të akuzës kontribut të veçantë për me zbardhë të vërtetën kish me dhënë mendimi i ekspertit të balistikës, nga se nga deklaratat e ekspertëve mjekësor nuk kemi arrijtë ta vërtetojmë këtë fakte, pra ka mbete e dyshimtë.

Trupi gjykues ka aprovuar propozimin e mbrojtësit dhe ka ftuar dhe ka degjuar ekspertin e balistikës L. R. .

**I akuzuari K. K.** në mbrojtjen e tij deklaroi se e njef B.B. nga vendi i punës, nga se me te kemi punuar bashkë në ndërmarrjen “.....” në Prizren, raportet me B.B. i kemi pas shumë të mirëma mirë se me të gjithë punëtorët tjerë, që të dytë kemi punuar në të njëjtin vend të punës si roje, në lokalet e”.....” në lagjen “.....”. Asnjëherë më parë me B.B. nuk kam patur kurrfarë problemi, mirëpo nja 2-3 ditë më herët me B.B. , meqenëse unë isha mbikëqyrësi i atij objekti ku sipërfaqja e atij objekti ishte 2x2 m, ai e ka patur ndërrimin e paradites, ndërsa unë të pas ditës, dhe kur kam shkuar që ta ndërrojë B.B. në orar të punës, e kam takuar aty dhe i kam thënë “qetu është e ndalume me pi duhan, sepse është vendi i vogël dhe pinte edhe me shokët tjerë”, B.B. më tha “ti nuk mund të ma ndalosh duhanin, dhe më ofendojë duke më thënë ti je i restoranve, kafeneve”, duke më ofenduar. Koha ka qenë rreth 15:15minuta, pastaj unë janë larguar, dhe kam shkuar që ti marr ato tiketat mi qit në vendin apo në lokalin ku kemi rujtur – në rojtore. B.B. vjen prej asaj hymjes ku ishim në zyrën e N. B. , zyre e udhëheqjes së kontrollit, dhe qysh isha duke i marrë ato tiketa nga ajo zyre aty ka ardhë B.B. nga mbrapa dhe më shajti dhe më tha pastaj “i kofsh falë motrës dhe shëndërrit tand se ta kisha hekë kryt”, këtë e ka bë edhe me shenjën me duar duke u fërkuar të dy duart-grushtat.

Të B.B. në shtëpin e tij kam shkuar pas 2-3 ditëve, shkak i kërcnimeve të tij dhe me disa thash e theme, që tek unë ka ndikue tek unë si ngarkesë psiqike dhe jam shku me u marrë vesh me B.B. se për çka po i bënë këto fjalë. Armën e mora me veti tue pa kërcnimet e tij prej punës e rrugës, prej frikës, kam marrë armën dhe shkova te B.B. në shtëpin e tij,

vetëmme u marrë vesh me te se çka janë ato të gjitha fjalët që i ka thënë më parë. Nështëpin e B.B. në lagjen “ ..... - ..... ” kam shkuar me bicikletë, armën e kam pas të vendosur në trup nën jakne. Kur shkova ish kon shoqja e B.B. tuj i la do enë në oborrin e vet, i thash “oj shoqja e B.B. a është B.B. në shtëpi, më tha po” i thash pastaj”thirre B.B. se kam një fjalë me te”, ajo më pyeti se kush jeni ju i thash se jam K.K. dhe punojë bashkë me B.B. . Ajo shkojë dhe ka shti kryt brenda derës, duke thënë “B.B. po të thirre K.K.”. Ka dalë B.B. me pushkë, pas gruas së tij (shtëpin e ka një katëshe dhe oborrin), dhe nuk më ka dhënë afat me fol hiq, dhe menjëherë ka gjujtë në drejtim timin me pushkë gjysëm automatike, 10-she, unë jom kon përtej rrugës, por kam qenë shumë afërme rreth 8 m. nga largësi kur ka gjujtë me pushkë, nuk i kam numru se sa fishekë ka shkrepur, ngase natën kritike kam qenë edhe nën ndikim të alkoolit, pas gjujtjeve B.B. ka hy bashkë me bashkëshorten e tij në shtëpi unë prej frigës se ai do të kthehet prej rrugës, kam gjujtë në drejtim nuk di, por në drejtim të shtëpisë.

Qendroj në tërsi pranë deklaratës time të dhënë në prokurori me datën 04.02.2015.

Në pyetjen e prokurorit se ju thatë se B.B. me bashkëshortën kanë hyrë brenda pse ti nuk u largove prej atij vendi, i akuzuari u përgjigj se këtë e thash edhe ma herët se ku e di unë se për çka hyni ai brenda, nga se nuk më priti mirë. Nuk më kujtohet se çfarë dite e javes ka qenë kur jeni fjalosur në punë.

Herën e fundit siç deklarova kur jamë fjalosur me B.B. nuk jemi takuar pastaj në vendin e punës me B.B. , ngase nuk vinte ndërrimi, unë edhe kam vazhduar punën pas fjalosjes së parë me B.B. .

Në pyetjen e mbrojtësit të tij se pse shkuat pikërisht në mbrëmje në shtëpin e B.B. por nuk shkuat ditën me u marrë vesh, i akuzuari tha se nuk e di, sepse atë ditë kam pirë alkool dhe kam pasur depresione në kokë.

Kur gruaja e B.B. hapi derën e shtëpisë dhe nga jashtë e thirri B.B. që të dalë, këtë e ndëgjova sepse isha afër, dikund 8 m. Kur kamë gjuajtur me armë B.B. dhe gruaaja e tij kanë qenë mbrenda në shtrtepi.

Në pyetjen e e mbrojtësit të tij se në prokurori keni deklaruar se gruaja e B.B. dhe B.B. kanë qenë në ballkon, e tani po deklaroni se ka qenë brenda në shtëpie, në momentin kur ke gjujtë cila është e saktë, I akuzuari shton se deklarova edhe sot se pas gjuajtjes B.B. kanë hy brenda, dhe unë kam gjujtë kur ata kanë qenë vetëm brenda në shtëpi.

**I akuzuari B. B.** në fillim deklaroi se qendron në tersi pranë deklëarates së tij të dhënë në prokurori më dt.03.02.2015. Para ngjarjes kamë punuar në “Hidroregjion” këtu në Prizren, në qendër, aty kamë punuar tri vite, aty ka punuar edhe K.K. . Se sa vite përpara ka punuar K.K. në Hidroregjion, nuk e di, por unë e kam gjetur aty.



Në Hidroregjion kam qenë në vendin e punës – roje, vitin e fundit kam punuar vetëm paradite si mirëmbajtës rregullimit të parkingut të automjeteve dhe objektit në “ortakoll”..

Vendi i rojes ka qenë kabinë tek dera hyrëse e oborrit të ndërmarrjes, ka qenë barak në një hapsirë 2,5 m x 2,5 m. Funksion i punës ka qenë si roje, një vit më parë kemi patur ndërrim në mes veti gjatë orarit, por vitin e fundit siç theksova kam punuar vetëm paradite. Ka qenë dhoma e njejtë – zyrja e njejtë e me të K.K. dhe deri në momentin kur jemi përta, mardhënjet kanë qenë jot ë mira, por edhe nuk kanë qenë të këqija.

Sa që më kujtohet ka qenë ditë e premte, por datën nuk e di, kur K.K. ka ardhur në vendin ku kam qenë duke punuar nja 40 minuta para se ta merr ndërrimin e vet, dhe unë aty kam qenë me një shok që është në cilësinë e kontrollorit F.B. , duke shikuar televizor, ka ardhë K.K. duke më ofenduar dhe duke më sha, është shprehur duke mëthënë “se ti i familjes keqe, familja e juaj është e pacipë, ti i ke tradhëtuar shokët kur ke qenë ilegale, por unë nuk ja vuna veshin duke dijtë se ky ka patur edhe njerzë mbrapa ditën kritike, i thash mos u “bon edhe ti ideot kërkush nuk është kah të frigohet edhe ti je rrit nëpër kafetë ish Jugosllavisë” dhe me kaq ka përfundu.

Kur ka filluar grindja në mes nesh, ka qenë rreth orës 15:20 minuta, kurse ndërrimi u ndërronte rreth orës 16:20, kjo kandodhë nja 2-3 ditë para natës kritike. Me kaq ka përfunduar dhe unë shkova pas ndërrimit në shtëpi pas orës 16:00 kur edhe mbarova ndërrimin.

Pas kësaj ngjarjeje të akuzuarit K.K. i, unë atij i kam dërguar në shtëpinë e tij selame me ane të mikut tij I. B. dhe dhe i kam lut që tia përcjellë K.K. që të më le rehat dhe secili ta kqyrim punën tone. I akuzuari K.K. në shtëpinë time me armë ka ardhur pas 2-3 dite, e që ka qenë ditë e hane. Në mes kohës kur jemi zënë me fjalë dhe ditës kritike me K.K. jam parë por nuk jamë takue. Kur K.K. ka ardhur me armë në shtëpi, më kujtohet ka qenë data 19 janar 2015, koha ka qenë rreth orës 18:00.

Për ardhjen e K.K. në shtëpinë time kamë kuptuar, de kur bashkëshortja ime ka qenë jashtë në oborr, nuk di a ka qenë duke larë diçka apo duke marrë dru, erdhi shoqja dhe më tha se po të thirr dikush jashtë, nga se K.K. i kishte thënë bashkëshorten thirre B.B., kam dalë në korridor e kam pa një bicikletë, e kam njohur në bazë të profilit që është i K.K., me një thesë në bicikletë, e pash profilin e K.K. , dhe vërtetova se është K.K. dhe u futa brenda në shtëpi për tëvesh diçka, nga se kam qenë me pixhame. Duke u futur brenda në shtëpi kam ndëgjue kur K.K. ka pregaditur armën në momentin kur u futa në korridor dera ishte qelë e shtëpisë dhe distanca ska qenë mbi 15 m, kur kam ndëgju zhurmën e pregaditjes së armës, unë kuptova se diçka nuk është në rregull, kam hyrë brenda kam marrë armën nën kauq dhe kam dashtë që me armë ta largojë rrezikun prej familjes, kam dalë në ballkon te dera, djali është vu mbrapa meje (ka patur një moshë 12 vjeçare) shoqja ka qenë para meje në krahun e djathtë, aty kam vërejtur duke ardhur gjuajtjet në drejtimin tonë, por edhe e kam pa K.K. jashtë oborrit në rrugë, po e kam pa kur K.K. ka gjujtur me armë.

Në pyetjen e mbrojtësit gjujte ti përpara kur ke dalë në ballkon apo K.K. ka gjuajte në drejtimin tand, i akuzuari tha se nuk e di me shtjellu këtë situatë sepse është situatë problematike. Por, plumbat kanë ardhë nga ana e kundërt.

Unë nuk e di se nga e kam marrë lëndimin por kam vërejtur kur nga këmba më rridhte gjaku, lëndimin e kam pësuar në atë moment kur kam shkrepur edhe unë me armë. K. K. e njofë në bazë të përmbajtjes fizike nga se një kohë të gjatë siç deklarova kam punuar me te.

Nuk e kamë pas kur e repetojë armën K.K. , por e kam ndëgjuar me vesh, në momentin kur në momentin kamë filluar të hyjë në shtëpi.

Kadriun gjerësa i ka zbrazur fishekët e kam parë, por më vonë më nuk e kam pa, por kur është larguar K.K. nga vendi i ngjarjes, biçikleta e tij ka mbetur e mbështetur në shtyllën elektrike, kur edhe ka ardhë dhe e ka marrë policia.

Avokati N. Q. : në fillim të deklarami të juaj deklaruat se mbeteni në tërësi në deklaraten e dhënë në prokurori për ato që janë deklaru, pse me datë 03.02.2015 kur sigurisht ngjarja për ju ka qenë ma e freskët keni deklaru ndryshe e pse sot ndryshe, kur keni dekluar se deri sake qenë brenda ke ndëgju një të shtënë faqe 3, pasusi 3 rreshti 10, kursesot po deklaroni sekeni ndëgjua rrafall, cila është e vërteta, i akuzuari tha jo, sot po përsërisë edhe një herë se kur kam hyrë brenda në shtëpi, kam ndëgjuar pregaditjen, repetimin e armës por krisma nuk kam ndëgju.

Në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit K.K. , avok N. Q. pse në prokurori në faqen e njejtë 3 pasusi 3 keni deklaru “pasi e mora armën kam dalë në ballkonin e përdhesis dhe kam shtënë pak më lartë se sa që ka qenë i pozicionuar K. K. para shtëpisë time, saktësisht kam bërë 7-8 të shtëna” dhe keni vazhduar në pasusin e 4 të njëjtës faqe “pas të shtënave të mija atëherë edhe K. K. është larguar më tutje në rrugë dhe nga një pozicion dikund në një largësi 15-16 m, nga ballkoni ku kam qenë unë ai ka shtënë në drejtim të ballkonit ku kam qenë unë...”, ndërsa sot po thoni që të shtënat kanë ardhë në fillim nga K.K. , cila është e vërteta, I akuzuari tha se e vërteta është se këta kanë gjujtë grupa e tyne, kolona e pestë.

Pastaj i njejtë avokat, se deklaraten në prokurori në faqen 3 pasusi i 4 në rreshtin 6 dhe 7 keni deklaru “unë nuk jam lëndu drejtpërdrejtë nga predha e armës por sikundër thash nga të shtënat në drejtim të shkallëve një copë e betonit është plasaritë dhe më ka lëndu”, ndërsa sot keni deklaru se keni pasur të djegur rroba në krah dhe keni pa këmbën e gjakosur dhe nuk e dini se me çka jeni lëndu cila është e vërteta, i akuzuari tha se unë nuk e di, i lënduar jam por nuk jam ekspertë të vlerësojë lëndimin e pësuar.

Avokati pastaj vazhdoj me pyetjen, sot në deklaratë ke thënë që ti ke dalë për herë të parë në korridor e ke vërejte profilin e K.K. pastaj ke vërejte që është K.K. dhe ke vërejte që ka pas një thes në bicikletë në prokurori në lidhje me thesin ke deklaru “K.K. është larguar nga vendi i ngjarjes biçikletën së bashku me një strajcë një thesë të bardhë ndoshta që e ka sjellë e ka lënë aty” cila është e vërteta, i akuzuari tha se nuk kam çka të përgjigjem në pyetje.

Parashtron kërkesë pasurore juridike, për këtë do të deklarohem në procedura e mëtejme kontestimore.

Gjykata, pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit, ndëgjimi i dëshmitarëve si dhe pas admnistrimit dhe analizimit të tët gjitha provavave të larëcekuaara, vërtetoi këtë gjendje faktike:

1. U veretue në tërsi se i akuzuari K.K. date 19.01.2015, rreth ores 18:00 minuta, në rr.” .... ” në lagjen “ ..... ” në Prizren, pas një mosmarëveshtjeje paraprake në vendin e punës, me dashje tenton të privon nga jeta të dëmtuarin B.B. , në atë mënyrë që i akuzuari K.K. shkon në shtëpin e B.B. me bicikletën e tij, fillimisht perms bashkëshortes që ishte duke larë enet në oborr, i thot asaj që ta fton bashkoshortin-B.B. , me pas B.B. del jashtë, e shef se aty ishte i akuzuari K.K., hynë mbrenda në shtëpin e tij, merr pushken gjysem automatike (10-she) me nr. serik II2308230 dhe i akuzuari K.K. fillon të shtënë pa ndërprerë me pushkën automatike AK-47 me numër serik 12108355 në drejtim të shtëpisë, edhe i akuzuari B.B. i përgjigjet duke shten me armë, me ç’ rast nga të shtena e të akuzuari K.K. , të akuzurit B.B. i shkakton lëndime të lehta me armë zjarri në parakrahun dhe shputën e këmbës së majtë të cilët dëmtime janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit, më përsëafërmi e përshkruar në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr.M.G. të datës 13.02.2015.

2. Me date, kohë dhe vendin e njejtë sin ë dispozitivin e pare të këtij aktvendimi për fillimin e hetimeve, i akuzuari mbanë në pronësi armën e zjarrit të markës AK-47 me numër serik 12108355 në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla, me ç’ rast arma i konfiskohet nga policia. Për këtë vepër penale është cekur më lartë në këtë aktgjykim, ku i akuzuari K.K. ka pranuar fajsinë.

**Është vertetuar në tërsi se i akuzuari B.B.** me date, kohë dhe vend të njejtë, si në dispozitivin të këtij aktvendimi, pa një mosmarëveshtje paraprake, në shtëpin e tij e përdorë në kundërshtim me Ligjine zbatueshëm armën gjysëmatommatike (10-she), me numër serik II2308230.

2.Me date, kohë dhe vendin e njejtë sin ë dispozitivin e pare të aktvendimit për fillimin e hetimeve, i pandehuri mbanë në pronësi pushkën gjysëmatommatike 10 (she) me numër serik II230820 dhe 36 fishekë të kal.7.62 mm, në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, me ç’ rast e njejtë i konfiskohet nga policia. Për këtë vepër penale është cekur më lartë në këtë aktgjykim, ku i akuzuari K.K. ka pranuar fajsinë.

### **Gjendja fkatike të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP**

Të akuzuarit K.K. dhe B.B. ka vite që janë njohur në mes veti, sepse një kohë kanë punuar në ndërmarrjen publike “.....” në Prizren në vendin e punës roje në vendin e quajtur “.....” në Prizren ku në hyrje të kësaj ndërmarrje kanë patur edhe një kiosk – roje dhe kanë punuar në bazë të ndërrimeve gjatë orarit të punës respektivisht i akuzuari K.K. ka zëvendësuar të akuzuarin B.B. , pasi ky i fundit ka kryer orarin e punës. Mirëpo 3 ditë para se të ndodhë rasti i akuzuari K.K. ma herët si zakonisht shkon për të marrë orarin e punës dhe aty brenda ka takuar të akuzuarin B.B. i cili ende në orarin e punës, mirëpo aty brenda fillon një zënkë në mes tyre rreth pirjes së duhanit ku i akuzuari K.K. ia tërhek vërejtjen B.B. që mos të pi brenda duhan as ai e as shokët e tij, duke i thënë “qetu është e ndalume me pi duhan sepse është vendi i vogël, pastaj K.K. i thotë B.B. “ti nuk mund të ma ndalojsh duhanin, pastaj fillojnë ofendimet ku B.B. thotë se ti je njeri i restoranteve dhe i kafeneve, K.K. ia kthen me fjalët “se ti je i familjes së keqe, familja juaj është e pacipë, ti i ke tradhëtuar shokët kur ke qenë në ilegale, por edhe duke i thënë K.K. “bonu edhe ti

idiot kërkush nuk është kah të frigohet dhe ti je rrit nëpër kafet e ish Jugosllavisë”. Koha e grindjes ka qenë rreth orës 15:20 minuta, ndërsa ndërrimi është dashur të bëhet në orën 16:20 minuta, ku me kaq ka përfunduar dhe i akuzuari B.B. ka shkuar në shtëpin e tij pas mbarimit të ndërrimit.

I akuzuari K.K. pas 2-3 ditëve, nga laxha ..... ku edhe banon me biçiklet është nisur dhe ka shkuar në shtëpin e B.B. në lagjen ..... dhe me vete ka marrë pushken automatike AK 47 siq tha vetem me u marrë vesh me te se çka janë ato të gjitha fjalët që i ka thënë më parë, dhe armën e ka pas të vendosur në trup nën jakne. Kur ka shkue, aty në oborrë ka takuar bashkëshorten e B.B. e cila ka qenë duke i larë enet në oborrin e vet, i drejtohet bashkëshortës së B.B. “oj shoqja e B.B. a është B.B. në shtëpi,” ajo i thotse po, pastaj i thot, ”thirre B.B. se kam një fjalë me te”, ajo e pyeti se kush jeni ju, i akuzuari thot se jam K.K. dhe punojë bashkë me B.B. . Ajo shkon dhe ka shti kryt brenda derës, duke thënë “B.B. po të thirre K.K.”. Del nga shtëpia i akuzuari B.B. dhe jashtë oborrit ka vrejtur të akuzuarin K.K. (kur thot e kamë parë profilin e K.K.), dhe duke u kthyr të hynë mbrenda në shtëpi, në momentin e hyrjes ka ndëgjue repetimin e pushkes, dhe kur ndëgjon, shkon siq tha ka marrë armën nën kauq dhe kur del jashtë shtëpisë, i akuzuari K.K. e vren të akuzuarin B.B. i cili kishte dalë në ballkonin e shtëpisë (sipas përshkrimit shtëpia është një kateshe) dhe fillon me gjuajtje rrafalle me pushkë automatike në drejtim të shtëpisë së B.B. .

Nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, është vërtetuar ngjarja ka ndodhur në rrugën “ ... ..... ” pa nr. në Lagjen ..... në Prizren, me saktësisht tek semaforët e kësaj lagjeje, në të djathtë në udhëkryqin e parë, në të majtë të përfundimit të kësaj rruge në të djathtë për në rrugën e cila qon në fshatin Gërničar-Prizren. Përballë xhamisë së kësaj lagjeje nga kjo rrugë në të majtë të saj gjindet rruga ... ..... pikërisht 100 m, më lartë ku ka ndodhur rasti si dhe shkëmbimi nga armët e zjarrit. Në kthesën në anën e djathtë të kësaj rruge gjindet shtëpia e të pandehurit B.B. , shtëpi një katëshe dhe nga jashtë e fasaduar me fasadë ngjyrë të bardhë. Oborri i shtëpisë në anën e parpame kah rruga dhe në anën e majtë të saj është e rrethuar me grila metalike ngjyrë të gjelbert. Në anën e parme, në qoshe në drejtim të shkallëve dhe derës së korridorit , oborri nuk është i rrethuar fare . Rruga në fjalë është e shtruar me kubëza betoni dhe se në të dy anët kishte trotuar të ngusht, poashtu me kubëza betoni.

Nga Njësia për Ekspertim të Armeve të Zjarrit-raporti i ekspertizës, i dt.0607.2015, është dhënë konstatimi përfundimtar se dëshmit D1 deri D20, D1 deri D8f , D11F deri D15F dhe D18F.1 janë 36 (tridhjetegjashtë) gëzhoja , pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62 mmx39 mm. Këto 36 gëzhoja janë shkrepur prej dy armeve të ndryshme të kalibrit të njëjtë 7.62x39 mm si më poshtë:

Tertë nga gëzhojat e dorzuara, dëshmitë D11F, 12F,13F,14F,15F dhe 18F.1, janë shkrepur nga pushka automatike Type 56 e dorzuar për ekzaminimin , dëshmia D19F.

28 (njëzetetë) gëzhojat tjera, dëshmitë D1 deri D20 dhe D1F deri D8F, janë shkrepur nga pushka automatike Type-56, E dorzuar për ekzaminimin, dëshmia #5M.

Dëshmit D18 dhe 19F, janë 36 fishek të kalibrit 7.62X39 mm.

Dëshmia D19F, është një pushkë gjysem automatike Type 56, kopje e pushkës automtaike Simonov-SKS, e kalibrit 7.63x39 mm, me numër serik 11230820, e cila ka të integruar karikataorin me kapacitet prej dhjetë fishekëve . Pushka gjysem automatike ka qenë funksionale gjatë gjuajtjeve testuese.

Dëshmia D20F është një (1) gjaketë e dëmtuar, pjesë e predhës të fishekut të kalibrit 7.62x39 mm, e cila është shkrepur nga pushka automatike Type-56, e dorzuar për ekzaminimin , dëshmia #5M.

Dëshmitë 5 M janë:a) një pushkë automatike Type -56, kopje e pushkës automatike AK-47, e kalibrit 7.62x39 mm, me numër serik 12108355 dhe 0509. Pushka automatike ka qenë funksionale gjatë gjuajtjeve testuese.

b) një (1) karikator i zbrazur me kapacitet prwej tridhjet (30) fishekëve i dizajnuar për pushklët automatike Type-56, kopje e pushkës automatike AK-47 e kalibrit 7.62x39 mm.

Eksperti i balistike është ftuar në shqyrtimin kryesor i cili ka theksuar se nga ekspertiza balastikore, nga laborator i balistikës resopektivisht nga ekspertiza e Ekspertit të balistikesi-L.Rr. , të dhënë me datën 06.07.2015, ekspertizë të cilen eksperti vet e ka punu, ka vertetu se ka qenë vetëm një xhakëtë pjesë e plumbit dëshmia D20F e cila në bazë të egzaminimet e bëra në vendin e ngjarjes, është konstatu se është shkrepur nga pushka automatike “Type 56” e dorëzuar nga dëshmia 5M,

Sa i përket armes-pushka “Type 56”, cila është përmenddur në aktakuzë është pushkë automatike AK-47, dhe se xhaketa është shkrepur nga pushka automatike “Type 56” e cila është e prodhuar në Kinë që është kopje e pushkën automatike AK-47, që është sjellë për egzaminim si dëshmia 5M, kjo është pushka automatike, ndërsa e kemi edhe dëshminë D19F që është një pushkë gjithashtu e modelit të njejtë por kjo është pushkë gjysëmatomatike,modeli është i njëjti për arsye se pushka automatike dhe kjo gjysëmatomatike kanë fillu të prodhohen në të njëjtin vit.

Sipas ekspertit, përveç kësaj arme “Type 56”,kopje e pushkës automatike AK-47 është dorëzuar edhe një armë tjetër në Forenzikë Është dorëzuar me shifrën D19F një pushkë gjysëm automatike “Type 56” që është kopje e pushkës gjysëm automatike SKS e kal.7.62 x 39 mm, me numër serik 11230820, e cila është e prodhuar në Kinë.

Në pyetjen tjetër të mbrojtësit a mund ekspertime na tregu sesa gëzhoja janë, gjetur dhe nga cilat armë janë shkrepë, eksperti u përgjigj se gjithsejtë në laborator janë sjellur 36 gëzhoja përegzaminim të kal.7.62x39 mm, tëgjitha kanë qenë të kalibrit të njejtë, këto 36 gëzhoja janë shkrepë prej dy armëve të ndryshme kalibrit të njejtë, 8 nga gëzhojat e dorëzuara dëshmitë D11F 12F, 13F, 14F, 15F dhe 18F.1 janë shkrepur nga pushka gjysëm automatike e modelit “Type 56” e cila është dorëzuar me numër referzues D-19F e cila mbanënumrin serik 11230820, si pushkë gjysëm automatike, ndërsa 28 gëzhoja tjera dëshmitë D deri në D20 dhe D1F deri D8F janë shkrepur nga pushka automatike “Type 56” nga dëshmia 5 M,emodelit AK-47 me numër serik 12108355, kjo armëka edhe një numër tjetër 0509 gjendet në mbuluesin e bartësit “shuli” .

Pushka automatike AK-47 ka karikator me kapacitet prej 30 fishekë, ndërsa ajo gjysëm automatike ka kapacitet prej 10 fishekëve pushka automatike shkrepë në dy mënyra, në rafalë në automatike dhe gjysëmautamatike (njënganjë) ndërsa ajo gjysëmautamatike shkrepë vetëm një nga një e jo vetëm automatike.

Sa i përket lëndimit, i pandehuri B.B. , 18.01.2015, është derguar në Spitalin Rajonal “prim.Dr.Daut Mustafa” në Prizren, për shkak të lëndimeve të marra (nga personi tjetër) me armë zjarri dhe në bazë të këtij raporti, sa i përket lëndimit të B.B. , është angazhuar eksperti mjekoligjor Dr.M.G. , i cili në raportin me shkrim i është referuar raportit të lëshuar nga Spitali rajonal në Prizren ku ka konstatuar se në bazë të raportit mjekësor të emergjencës së Prizrenit, në mes tjerash konstatohet dijagnoza vulnera sclopetarja (susp.) antebraçih etpedis l.sim. që në shqip don të thotë plagë me armë zjarri (e dyshimtë suspekta) në parakrahun dhe shputën e këmbës së majtë. Një plagë e tillë shkaktohet nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit, në pyetjen e avokatit për fjalën e dyshimtë këtë çështjen suspekt ose dyshimtë doktori në raportin mjekësor e ka shënuar në bazë të anamnezës ose historiku të ngjarjes që ia ka dhënë i demtuari.

Sa i përket llojit të plagës, ashtu siç është shënuar edhe ka spjeguar më herët, në bazë të dijagnozës, ka vertetu se kjo është plagë nga armë zjarri, nuk është plagë shqyese, nuk është plagë ndrydhëse, nuk është prerëse, nuk është shpuese nuk është korozive etj, por është plagë nga armë zjarri, në bazë të raportit të emergjencës, eksperti ka perseritur se kur e kemi të shënuar këtë lloj të plagës ne e shenojmë mjetin që e shkakton atë plagë, pra plaga është shkakuar me veprim dinamik i predhës së armës së zjarrit.

Eskpertit i është dhënë në shiqimi disa fotografi të cilat prokurori i shtetit i dorëzon trupit gjykues, të gjitha fotografitë janë me ngjyra-color, dhe në bazë të ekspertit i cili ka shiqu fotografit dhe plaga që e pash në parakrahun e majtë, shkon në favor të asaj që ka shënu doktori në raportin e emergjencës, ku pastaj ka theksuar se nëse unë si mjek ligjor do të bëja egzaminimin e personit të caktuar qoftë i dëmtuar apo i akuzuar sa është plaga e freskët unë të njejtin konstatim do ta kisha dhënë.

Në pyetjen e prokurorit : a mundeni me na tregu a keni pas ndonjë raportin e radiologut se në konsultimet tjera specialistike V. Në raportin e Qendrës emergjente shih raportin e radiologut A e keni pas këtë raport të radiologut dhe çfarë ka mujtë me qenë ai raport i radiologut, eksperti theksoi se raporti i radiologut thotë: excoriationom antebraçhisin.vulnos nuk mund ta deshifrojë pedis, sin (rikoshe) që në përkthim don të thotë gërvishtje e parakrahut të majtë dhe plagë që nuk mund ta deshifrojë, e në shputën e këmbës së majtë (i referohet rikoshe), i tërë raporti është përmbledhur në dijagnozën që e kemi shënuar. Radiologjia është një drejtim i mjeksisë që kryesisht mirret me përshkrimin imazherik përmes instrumenteve të caktuara në këtë rast qoftë rentgeni, CT-ja, rezonanca magnetike e tjera. Në pika të shkurta është kjo: ata përshkruajnë ato që shohin në këto imazhe zakonisht me imazhe paraqiten trupa e huaj, thyerjet, nivelet hitroajrike në orgnaizëm, por shumë pak mund të ofrojnë informacion për dëmtimet e indeve të buta se ato në imazhe nuk paraqiten.

Në këtë çështje penale është ndegjuar edhe deshmitari **S.H.**, në fillim i është dhënë në shiqim raporti mjekësor me nr. .... datës 19.01.2015 e lëshuar nga Spitali Rajonal “Prim. Dr.Daut

Mustafa” pastaj theksoj se këtë raport të cilin e kam me veti në shiqim e kam përpiluar unë edhe është konsultuar ortopedi duket shënimi i tij Dr.M.G. , është kërkuar edhe vlerësimi i radiologut S.B. .

Sa më kujtohet në dokumentacion plagët kanë qenë shpuesë në brylin e majtë dhe në shputën e majtë, një mangësi në raport edhe pse është shënuar plaga në krahun e majtë/, mirëpo ma andej nuk është vazhduar për asye se për shkak të mbingarkesave atë ditë që ka patur në Qendrën e Emergjencës.

Në pyetjen e mbrojtësit se në raport keni konstatuar se është fjala për plagë me armë zjarri (keni shënuar si “të dyshimtë”) ajo qka më intereson a keni biseduar me pacientin se si është lëpnduar, deshmitari thot se personi i cili kërkon ndihmën mjeksore kur është në vetëdije ne e pyesim direkt ate dhe se fjalët e tija janë të rëndësishme për të bërë dijagnozën dhe konstatimin sa më efikas Normal që ka vështërsi se ne gjatë punës shumë vjeçare, por megjithatë ne bazohemi edhe në të dhënat që na ofrojnë vet pacientët ose familjarët të gjithë çka bëjmë ne që ta japim dijagnozën sa më të saktë.

Në bazë të dhënave të cilat na ka dhenë i dëmtuari dhe familjarët, kam dyshu se është plagë e shkautar nga arma e zjarrit dhe i kam lokalizua vendet ku kanë qenë ato plagë të shkaktuara.

Se i akuzuari B.B. ditën kritike e ka përdorur armen-pushken gjysem automatike (10-tshe) me numer serik II2308230, gjëndja faktike është vërtetuar nga vet deklarata e të akuzuarit B.B. , të akuzuarit K.K. dhe deshmitares B.B.1-bashkëshortes së të akuzuarit B.B. .

I akuzuari B.B. , pranoj se ditën kritike e ka përdorur armen, por siq than ë vet mbrojtje nga se ka qenë isulmuar prapakisht nga i akuzuari K.K., mirëpo duke iu referuar deklaratës së tij, bindja e trupit gjykues ishte se tek kjo ngjarje ka ardhur si shkak i raporteve jo të mira në mes të të akuzuarve, kur siq shifet edhe nga deklaratat e tyre, ata tri ditë më heret kishin patur konflikt verbal në vendin e tyre të punës, se ditën kritike i njejtë e ka pa të akuzuarin K.K. (shih për këtë deklaratën e tij se (“kam vrejt K.K. para oborrit, ia kamë pa profilin dhe e kam njoft se është K.K.), ai edhe siq tha kur ka ndëgjue repetimin e pushkes nga ana e K.K. , nuk është dashur që të hynë në shtëpi dhe të marrë armen dhe të dal perseri jasht shtëpisë, dhe të konfrontohet me armë me të akuzuarin K.K. .

**Mbrojtësi i të akuzuarit K.K. , avok.N.Q. ,** fjalën përfundimtrare gjykatës ia ka deponuar me shkrim, ku nder të tjera në në të ka cekur: në çështjen penale kundër të akuzuarit K. K. që nga fillimi i kësaj procedure edhe në fazën hetimore sa i përket veprës penale si në dispozitivin II/ të aktakuzës ka pranuar fajsinë, prandaj mbrojtja do të orientohet vetëm në pikën I/ të dispozitivit të aktakuzës, me të cilën i akuzuari ngarkohet për veprën penale vrasje në tentativë nga nei 178 lidhur me nenin 28 të KP. Avokati mbrojtës pastaj ka shtuar se provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor kanë vërtetuar këtë gjëndje faktike.

I akuzuari K.K. ka punuar në vendin e njejtë me të akuzuarin B.B. , kanë patur raporte të mira deri 3 ditë para se të ndodhë rasti i cili është objekt i shqyrtimit në këtë procedurë penale, pra me datë 19.01.2015, ttë akuzuarit K.K. dhe B.B. kanë pasur një konflikt verbal në lidhje me punën

dhe ka ardhur deri te prishja e raporteve të tyre për faktin se kanë shkëmbyer fjalë të rënda për njëri tjetrin. Me datë 19.01.2015 në orët e mbrëmjes, i akuzuari K.K. nën ndikim të alkoolit e duke ndie keq për fjalët që i kishte thënë i akuzuari B.B. , sidomos kërcnimin përmes gjesteve “se dot’ ia këpusë kokën”, merr pushkën automatike e vendosë në pallto e mbështetur për trupi dhe niset me bicikletë nga lagja “ .... . . .” ku banon për në lagjen “.....” ku ka shtëpin B.B..

Sipas deklaratës së dëshmitares B.B.1 që është bashkëshortja e B.B. , K.K. në momentin kur arrin në afërsi të shtëpisë së B.B. thërret në emër të tij, dëshmitarja del në ballkonin e shtëpisë në katin përdhese, i akuzuari K.K. i tregon se është K.K. dhe i thotë që ta thërret B.B. të dele dhe të takohet. Në këtë moment i akuzuari B.B. del nga shtëpia dhe me pushkën e tij gjysëm automatike, shkrepë, çka shkakton frigë, ankth për të akuzuarin Kadri i cili në gjendjen në të cilën ishte i dehur tronditet dhe gjuan pa kontrollë, duke shkrepur me pushkë automatike, me rafal.

I akuzuari B.B. nga copat e betzonit të shkëputura si pasojë e goditjes me predha, lëndohet në këmbë dhe në krah gjë që i shkakton lëndim të lehtë trupor. Pas kësaj i akuzuari K.K. hikë nga vendi i ngjarjes i frikësuar se mos po vazhdon B.B. të shkrepë me armë.

Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga deklarata e të akuzuarit K.K. , pjesërisht nga deklarata e të akuzuarit B.B. dhe nga skica, fotografitë nga vendi i ngjarjes dhe provat që i ka siguruar policia me rastin e daljes në vend. Në këto rrethana të vërtetuara, me fakte të provuara, dele se i akuzuari K.K. armën e ka poseduar me vete për dy arsye, e para për shkak se ishte në gjendje të dehur dhe nuk është se ka kontrolluar veprimet e tija dhe e dyta për shkak se ka qenë i frikësuar edhe pse ka shkuar ta takojë të akuzuarin B.B. për tu sqaruar dhe për ta zgjidhë konfliktin verbal dhe keqkuptimet me të, frikë e cila ka qenë e arsyeshme.

Përndryshe nuk ka logjikë dhe nuk mund të vërtetohet se i akuzuari K.K. të ketë shtënë i pari, nuk mund të vërtetohet nmdryshe konstatimi i mësipërme sepse sikur të kishte shtënë i pari me armë i akuzuari K.K. , atëherë shtgrohet pyetja si e ka dijtë i akuzuari B.B. që i akuzuari K.K. ka ardhë, për më tepër sikur i akuzuari K.K. të kishte pas qëllim apo të kishte dëshiruar kryerjen e veprës penale për të cilën ngarkohet, duke marrë parasysh largësin e tij dhe të akuzuarit B.B. , sigurisht që do të kishte shkaktuar pasoja, çka vërteton se krejtë situata që ka ndodhë aty për aty, e atëçastëshme e pa planifikuar dhe si rezultat i veprimeve që fillimisht i ka marrë i akuzuari B.B. . Nga këto konstatime si më lartë vërtetohet se aktakuza e prokurorisë, nën dispozitivin I/ nuk qëndron sepse me asnjë fakte nuk është vërtetuar konstatimi se me dashje tenton ta privon nga jeta të dëmtuarin B.B.”, siç nuk ka arrijtë të vërtetohet as konstatimi nëd ispozitiv në pikën I/, se i akuzuari pa kurrfarë paralajmërimi fillon të shtënë pa ndërprerë e as konstatimi se shkakton lëndime të lehta me armë zjarri.... dëmtimet janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës.....”, për shkakun se të gjitha provat vërtetojnë se të shtënat ka filluar i akuzuari i dytë, ndërsa lëndimet që i ka pësuar nga të gjitha raportet mjeksore janë si të dyshimta.

Në shqyrtimin gjyqësor është ndëgjuar në cilësin e dëshmitares, bashkëshortja e të akuzuarit B.B. znj. B.B.1 , e njejta është dëgjuar edhe në prokurori dhe nga dy deklaratat që janë administruar si provë dhe deklarata e dhënë në polici, dele e vërtetuar se i akuzuari B.B. ka dalë i pregaditur me armë nga dera e shtëpisë dhe ka shtënë. Me rastin e administrimit të provave materiale, siç janë raportet mjeksore dhe konkretisht raporti i lëshuar nga Qendra emergjente në



Prizren nr.1454, nga akt ekspertimi mjeko-ligjor i datës 13.02.2015 dhe nga dëgjimi i ekspertëve në seancën gjyqësore të datës 15.10.2015 është vërtetuar se lëndimet e të dëmtuarit B.B. ditën kritike janë të dyshimta dhe mund të jenë shkaktuar edhe nga arma e zjarrit, mirëpo vet i akuzuari B.B. në deklaratën e tij të dhënë me datën 03.02.2015, në procesverbalin mbi marrjen e deklaratës në prokurori Hep.nr.8/15, në faqen 3 në pasusin 4 ka deklaruar, “unë nuk jam lënduar drejtpëdrejtë nga predha e armës por sikundër thash nga të shtënat në drejtim të shkallëve, një copë e betonit është plasaritur dhe më ka lënduar....” nga rreshti i 6 deri në rrestin e 8.

Me dëgjimin e ekspertit të balistikës në seancën e shqyrtimit kryesor, nga dëshmitë e gjetura, në vend të ngjarjes, padyshim është vërtetuar se të dy të akuzuarit kanë shtëne me armë dhe logjikisht por edhe shkencërisht është provuar se sikur ndonjëri nga këta të akuzuar të kishin pasur qëllim (dashje) do ta kishin arrijtë qëllimin, por pa asnjë mëdyshje të gjitha provat vërtetojnë se i akuzuari K.K. armën e ka përdorur nga frika dhe me qëllim të frikësimit për të akuzuarin tjetër. Nga vërtetimi i kësaj gjendje faktike, dele se gjykata aktakuzën siç është cilësuar dhe përshkruar faktikisht dhe juridikisht nuk duhet ta vërtetojë, nga se provat kanë vërtetuar se i akuzuari K.K. ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP. Pra mbrojtja deklaroi se nuk janë formuar elementet qenësore të veprës penale siç është përshkruar në dispozitivin nën I/ të aktakuzës, kjo për faktin se për tu plotësuar elementet qenësore të kësaj vepre penale, kërkohet që të ekzistojë dashja siç është përcaktuar në nenin 21 të KP, e që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë as me dashje direkte ose eventuale. I akuzuari ka shtëne pa kontroll dhe nuk ka pas qëllim dhe në situatën në të cilën është ndodhë nuk ka shtëne siç u tha disa herë nga frika.

Gjykatës i propozojë që të akuzuarin K.K. me rastin e marrjes së vendimit të ri të cilësojë veprën penale nga dispozitivi nën I/ të aktakuzës, duke shpallë fajtor për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP, ndërsa ka shpallë fajtor për veprën penale si në dispozitivin nën II/ pasi që për këtë vepër ka pranuar fajsinë, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit për llojin dhe lartësin e sanksionit penal të vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese siç janë: qëndrimi dhe sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, pranimi i fajsisë për veprën penale për të cilën është deklaruar fajtor, pranimi i veprimeve të përshkruara në aktakuzë, faktin që i akuzuari asnjëherë pas këtij rasti nuk ka ra ndesh me Ligjin, pendimin e thellë të shprehur për veprat e kryera dhe premtimin se kurr më nuk do të bie ndesh me Ligjin, kërkim faljen dhe shprehjen e thellë të keqardhjes në raport me të dëmtuarin B. B. , faktin se i akuzuari ditën kritike ka qenë i dehur dhe nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë plotësisht veprimet e tij dhe se është përdorues i alkoolit në varësi të tij gjë që vrteton i akuzuarin, nuk është dele me qëllim të kryerjes së veprës penale si dhe korektësin e treguar në të gjitha fazat e procedurës.

Këtë konstatim të mbrojtësit të akuzuarit, trupi gjykues nuk e mori për bazë sepse kur ka patur ofendime e posaqerisht kërcnimi i akuzuarit kështë dashur ti lajmëroj organet e rendit e jo pas tri ditve të merr armen prej lagjes ..... të shkon në shtëpinë e B.B. në Lagjen ..... , pastaj edhe faktin se ndikimi i alkoolit nuk liron nga përgjegjësia penale.

Edhe konstatimin e mbrojtësit se se sikur të kishte shtinë me armë i akuzuari K.K. atëherë sipas mbrojtësit, shtrohet pyetja se se si e ka ditur i akuzuari B.B. që i akuzuari K.K. ka ardhë, për më tepër që i i akuzuari K.K. të kishte pas qëllim apo të kishte dëshiruar kryerjen e veprës penale, trupit gjykues nuk e mori për bazë nga se nga vet deklaratat e të akuzuarve, të njëjtët qysh tri ditë më parë kanë patur zënka verbale duke iu kercnuar njeri tjetrit, që të dy të akuzuari e kanë ditur rrezikun nga njeri tjetri.

**Edhe mbrojtësi i të akuzuarit B.B. , av. R.K. ,** gjithasht fjalën përfundimtrare gjykatës ia ka deponuar me shkrim, ku nder të tjera në në të ka cekur:theksojë se Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda me datën 17.03.2015, kur të akuzuarit B.B. ngriti aktakuzë sipas të cilës i akuzuari ngarkohej se ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP.

Aktakuza e ngarkon të akuzuarin B.B. se me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të parë të aktakuzës, pas një mosmarëveshje paraprake pasi ka qenë i sulmuar paraprakisht nga i akuzuari i parë K.K., në shtëpin e tij e përdorë në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm armën, pushkën gjysëm automatike (10-she) me numër serik II2308230 dhe për veprën e dytë me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin e parë të aktakuzës, i pandehuri mbanë në pronësi, pushkën gjysëm automatike (10-shte) me numër serik II230820 dhe 36 fishekë të kal.7.62 mm, në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, me ç’ rast e njejtja konfiskohet nga policia.

Nga provat e administruara, deklarata e dëshmitares B.B.1 , deklaratat e të akuzuarëve, K. K. dhe B.B. si dhe shkresat e lëndës me padyshim vërtetohet fakti se 2-3 ditë para ditës kritike, dikund rreth orës 15:00 në vendin e tyre të punës kishin pasur konflikt verbal të akuzuarit K. K. dhe B.B. . Deri te konflikti verbal kishte ardhur për shkak se i akuzuari B.B. në lokalin ku bënte roje në vendin e punës së tij, kishte përdorur duhan (cigare) ndërsa i akuzuari K.K. nuk e kishte duruar tymin e cigareve dhe kishte ardhur deri te konflikti verbal, por pa pasoja.

Pas 3 ditëve, ditën e hënë me datë 16.01.2015 rreth orës 19.40 minuta, i akuzuari K. K. kishte marrë armën e vet, pushkën automatike AK-47 me numër serik 1208355 dhe me një bicikletë kishte kërkuar në kërkim të shtëpisë së të akuzuarit B.B. dhje në fillim e kishte vërejtur bashkëshortën e të akuzuarit B.B. në oborrin e shtëpisë dhe i kishte thënë që ta thërras B.B. . I akuzuari B.B. me atë rast kishte dalë për paraprakisht kishte marrë armën e vet, pushkën gjysëmautomatike (10-she) me numër serik II230820 me 36 fishekë të kal.7.62 mm, dhe posa kishte dalë në ballkon të shtëpisë i akuzuari K.K. kishte shti në drejtim të vet me armë disa herë, nëtëcilën raste ngajshëm ishte përgjigjur edhe i a kuzuari B.B. . Në rastin e tillë parashtrohet pyetja se veprimet e që i kishte marri i akuzuari B.B. a mund të trajtohen si veprime inkriminuese, pasi që natën dhe orën kritike kishte përdorë armë. Dispozitivi i aktakuzës lidhur për këtë vepër penale thotë: pas një mosmarëveshje paraprake pasi ka qenë i sulmuar paraprakisht nga i akuzuari i parë K.K. në shtëpin e tij, e përdorë në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm armën dhe etj...

Nga përshkrimi faktik i këtij dispozitivi dhe në vijim të gjitha provat e adeministruara, me padyshim rezulton fakti se i akuzuari B.B. e përdori armën pasi paraprakishte ishte sulmuar me armë nga i akuzuari K.K. dhe ate në shtëpin e tij gjatë natës.

Mbrojtja konsideron se në rastin konkret i akuzuari B.B. armën e përdori pa dëshirë dhe vullnetin e tij por ishte e domosdoshme që ta përdorte në momentin e caktuar për ta evituar sulmin e atçasshëm, të menjëhershëm dhe të rrezikshëm për veti dhe familjen e tij. Ndaj veprimet e këtilla nuk paraqesin vepër penale në kuptim të dispozitave të nenit 12 të KP, sepse i akuzuari armën e përdori në vet mbrojtje.

I akuzuari B.B. ishte e domosdoshme të ndërmyrte veprime të tilla sepse në drejtim të tij, familjes së tij dhe shtëpisë së tij ishte përdorur sulmi me armë zjarri nga i akuzuari i parë K.K. dhe B.B. ishte i detyruar që të reagonte ngjajshëm për ta evituar apo për ta parandaluar sulmin e tillë. Çdo person që ndodhej në atë situatë dhe në atë gjendje do të reagonte ngjajshëm dhe veprimet e tilla nuk paraqesin vepër penale sepse janë ndërmarrë për ta mbrojtur vehten dhe familjen e vet.

Andaj në kuptim të dispozitave të nenit 364 par.1 nënpar.1.1 të KPP, i propozojë gjykatës që të merr aktgjykim lirues për shkak se vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përmbanë vepër penale, ndërsa sa i përkeet veprës së dytë penale, mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga nei 374 par.1 të KP, meqenëse i akuzuari B.B. për këtë vepër penale e ka pranuar fajsinë, i propozojë gjykatës që të njëjtit ti shqiptohet një dënim me gjobë më i butë duke i marrë përbazë të gjitha rrethanat e rastit.

Mbrojtësi itë akuzuarit B.B., av. R.K. në fjalën prfundimtre të deponuar me shkrim ka kontestue vepren penale perdorimi i armes apo mjetit të rrezikshem nga neni 375 par.2 duke shtuar par.2 i nenit 375 bie ndeshme veprimet inkriminuese dhe pershkrimit faktik se i ajkuzuari siq thot armen nuk e ka perdor me qellimi frikësimi apo kercnimi, e këtë dilem e ka hequr prokurori i shtetit kur në fjalën përfundimtare ka ber rikualifikimin e vepres penale nga paragrafi 2 në paragrafin 1 të nenit 375, kur ka kerkuar që i kauzuarit të shpallet fajtor për vepren penale nga neni 375 par.1 të KP. Gjithashtu trupi gjykues nuk muar për bazë konstatimin e mbrojtësit se i akuzuari se i akuzuari B.B. ka qenë apo ishte e domosdoshme të mirrte veprime të tilla kur dihet fakti se i mosmarrveshtjes paraprake në njeran anë dhe momentin se i akuzuari B.B. e kur del nga shtepia e tij e shef (ka pare prifilin, siq ka deklaruar më heret) se para oborrit të tij po e priste i akuzuari K.K. , hynë në shtepi dhe merr armen shkemben zjarrë më të akzuarin K.K. .

Pra, për të vertetuar këtë gjendje faktike, gjykata në tersi mori për bazë deklaratat e deshmitarve B.B.1 , Dr. S.H. , raportin mjeksor nga Spitali Regjional në Prizren, , raportin mjekësor të Dr. M.G. dhe elaborimin detal në shqyrtimin kryesor dhe të gjitha provat që janë bashkangjitur kësaj lende penale, sepse deshmit e tyre dhe provat material ishin bindëse më të cilat deshmi treguan terë ngjarjen duke filluar nga vendi, koha menyra dhe pasojat e ngjarjes së ndodhur në shtëpin e B.B., mes të akuzuarve K.K. dhe B.B. , ku për pasoj ka mbet i lënduar lehtë i akauzuarit B.B. .

Gjykata, gjatë shqiptimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, e në kuptim të nenit 73 të KP-së, pati parasyshë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit. si, rrethanë rënduese gjykata pati parasyshë shkallën e përgjegjësisë penale, dhe veprat penale më padyshim se i kanë kryer me dashje eventuale duke qenë në tërësi i vetëdijshëm për shkaktimin e pasojave për këtë vepër penale respektivisht kanë pranuar që të shkaktojë pasojat e ndaluara me Ligj duke marrë parasysh motivin e mosmarrveshtjeve të mëparshme të tyre të mëhershme e në këtë drejtim Gjykata kishte parasyshë edhe intenzitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur. Gjykata pati parasyshë edhe rrethanë posaqërisht lehtësuese, sjelljen korrekte e të akuzuarve në të gjitha fazat paraprake dhe fazat gjatë shqyrtimit kryesor, gjerë më tani të padënuar, kur shqiptoj dënimin nën kufirin e parapar me ligj, për këtë edhe gjykata secilit të akuzuar ia shpall dënimet e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykim e bindur se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi konfiskimi, u muar në kuptim të nenit 375 par.3 të KP..

Vendimi mbi paushallit gjyqësor, gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2 pika 6 të KPP.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u muar në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP.

**Sek.juridike,  
Fatmire Kastrati**

**Kryetari i trupit gjykues  
Xheladin Osmani**

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,  
-Departamenti për Krime të Rënda  
P.nr.43/2015, më datë 09.03.2016**

**UDHËZIME JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.











